



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 07.05.2018	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-144

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Këshilli Drejtues

Nr. ref. 144

Prizren, 07.05.2018

Duke u mbështetur në dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" nr. 04-V-621 të datës 30.05.2013 dhe dispozitave ligjore në fuqi, Këshilli Drejtues i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 20.04.2018 mori vendim për të shpaluar:

KONKURS

Për lirim nga pagesa e semestrit për studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren për vitin akademik 2017/2018

Të drejtë aplikimi për lirim nga pagesa e semestrit për vitin akademik 2017/2018 kanë:

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale;
2. Studentët, të cilët janë invalidë ose veteranë të luftës;
3. Studentët, që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës dhe fëmijët e Invalidëve ose veteranëve të luftës;
4. Studentët me aftësi të kufizuara fizike;
5. Studentët e të njëjtit prind i cili ka dy (2) e me shumë studentë të rregullt në studime në Universitetet publike të Kosovës.

Të gjithë studentët duhet t'i paraqesin:

- Kërkesën për lirim nga pagesa e semestrit (formular i aplikimit);
- Vërtetimin e studimeve për vitin akademik 2017 - 2018;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e kartelës së llogarinë bankare (personale) si dhe
- Fletëpagesat e semestrave për të cilët aplikon.

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale, i paraqesin edhe:

- a. Kopjen e vërtetuar të vendimit të ndihmës sociale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ;
- b. Kopjen e letërnjoftimit të bartësit të ndihmës sociale;
- c. Certifikatën e lindjes së studentit/ës.

2. Studentët, të cilët janë invalidë ose veteranë të luftës i paraqesin edhe:

- a. Kopjen e vërtetuar të vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;

3. Studentët, që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës dhe fëmijët e Invalidëve ose veteranëve të luftës i paraqesin edhe;

- a. Kopjen e vërtetuar të vendimit nga MPMS për njohjen e statusit të familjes së dëshmorit, viktimës civile, invalidëve dhe veteranëve.
- b. Kopjen e letërnjoftimit të bartësit të statusit të familjes së dëshmorit/viktimës civile;
- c. Certifikatën e lindjes së studentit/ës.

4. Studentët me aftësi të kufizuara fizike i paraqesin edhe:

- a. Kopjen e vërtetuar të vendimit për njohjen e statusit person me aftësi të kufizuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose nga shoqatat e licencuara të personave me aftësi të kufizuara;

5. Studentët e të njëjtit prind duhet të paraqesin:

- a) Certifikatën e lindjes së studentëve;
- b) Vërtetimet e të gjithë studentëve për regjistrimin në vitin akademik 2017/2018.

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën nr. 526, administrata qendrore, zyra e personelit.

Kërkesat dhe dokumentacioni i pranuar zyrtarisht nga zyra nr. 526 i dorëzohet Komisionit për vlerësim dhe verifikim të dokumentacionit të formuar nga Këshilli Drejtues.

Afati për konkurrim është prej datës 07. 05. 2018 e deri më 21. 05. 2018.

Format e nevojshme për konkurrim gjenden në ueb-faqen e Universitetit të Prizrenit: [www. uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com) dhe në Zyrën nr. 526.